



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1442, datë 12.11.2010

Për

“Disa ndryshime në VKD nr.1393 datë 27.09.2010 “Për miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Plus Communications Sh.A me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 12.11.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për “Ndryshime në VKD nr.1393 datë 27.09.2010 “Për miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Plus Communications Sh.A me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”;

BAZA LIGJORE:

1. Neni 99 i Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 11 dhe 128 i Ligjit Nr. 8584, datë 12.1999 “ Kodi i Proçedurave Administrative”
3. Ligji nr.9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”(Ligji nr.9902);
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- relacion shpjegues (*relacioni*);
- projektvendim i KD (*projektakti*);
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendim Nr.1393, datë 27.09.2010 ka miratuar Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Plus Communications Sh.A. me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të levizshme.
2. Plus Communications me kërkesën nr. 738 datë 28.10.2010 kërkon të ketë të njëjta kushte të barazisë për të gjithë operatorët duke mos vendosur në pozita të disfavorshme operatorët e rinj në treg për parashikime të vendosura tashmë për operatorët e tjerë në lidhje me nenin 11./Pika 11.2 te “Përfundimi i Kontratës”, dhe nenin 18.Pika 18.1 te Vlefshmëria/Afati/Zbatimi i detyrueshëm i kontratës.
3. Plus Communications Sh.A.ka kërkuar nga AKEP të shtojë në kontratën e tij në pikën 11.2 në fund të paragrafit fjalinë e mëposhtme:
Në rast se mbarimi i kontratës kryhet nga Pajtimtari brenda afatit fillestar të kontratës prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, Pajtimtari ka detyrimin të paguajë tarifën mujore fikse për të gjithë periudhën 12 (dymbëdhjetë) mujore”
Neni 18. Vlefshmëria/Afati/Zbatimi i detyrueshëm i kontratës/Pika 18.1, ka kwrkuar tw riformulohet, “Kjo Kontratë lidhet për një afat fillestar prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.Pas kalimit të këtij afati, Kontrata rinovohet automatikisht për një afat të pacaktuar përveç rastit kur Pajtimtari njofton me shkrim PLUS se nuk dëshiron vazhdimin e kohëzgjatjes së Kontratës përtej këtij afati 12 mujor” .
4. AKEP konstaton se në kryerjen e ndryshimeve të kësaj kontrate udhëhiqet nga parimi i barazisë në kuptim të nenit 11 të Kodit të Procedurave Administrative, që asnjë prej kontratave të miratuara për pajtimtarët e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në treg të ketë kushte të ndryshme nga të tjerët dhe të diskriminohet.
5. Në kuptim të parimit të barazisë AKEP konstaton se rrethanat dhe kushtet konkrete kërkojnë ndryshime në kontratën e Plus Communications Sh.A. të miratuar, kjo për të mos sjellë kushte të pabarabarta.
6. Nga rishikimi i paragrafëve të përmendur në Plus Communications Sh.A., rezulton se ka nevojë për ndërhyrje dhe plotësim të pikës 11.2, për heqje të një pjese të fjalisë të 18.1, dhe jo për riformulim të plotë të kësaj të fundit.
7. AKEP, me qëllimin e mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, bazuar në:
 - a. Qëllimin e garantimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në Shqipëri, të shprehur në nenin 1 të ligjit nr. 9918, dhe
 - b. Objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në gerrat ‘a’ dhe ‘b’, pika 3, neni 7 i Ligjit nr. 9918.ka konsideruar dhe vlerësuar reflektimin e propozuar nga sipërmarrësi Plus Communications Sh.A.si të arsyeshëm në termat e përgjithshme të kontratës ;
8. Ndryshimi i propozuar në termat e përgjithshëm nga Plus Communications Sh.A. ka marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e ndryshimit të kushteve të përgjithshme të kontratës tip, bazuar në nenin 11 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në parimet e barazisë dhe proporcionalitetit që administrata publike duhet të respektojë gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj administrative,

V E N D O S:

1. Ne VKD nr.1393 datë 27.09.2010 “Per miratimin e Termave te Pergjithshme te Kontrates (Kontrate Tip) së Plus Communication sh.a me pajtimtarin per sherbimin e telefonise publike te levizshme” te miratoje ndryshimet si me poshte vijon:
 - a) Ne nenin 11, “Termat te Pergjithshme te Kontrates (Kontrate Tip) së Plus Communication sh.a me pajtimtarin per sherbimin e telefonise publike te levizshme”, “Përfundimi i kontratës”, pika 11.2 të shtohet paragrafi si me poshte vijon:

“Në rast se mbarimi i kontratës kryhet nga Pajtimtari brenda afatit fillestar të kontratës prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, Pajtimtari ka detyrimin të paguajë tarifën mujore fikse për të gjithë periudhën 12 (dymbëdhjetë) mujore”
 - b) Ne nenin 18 te “Termat te Pergjithshme te Kontrates (Kontrate Tip) së Plus Communication sh.a me pajtimtarin per sherbimin e telefonise publike te levizshme”, “Vlefshmëria/Afati/Zbatimi i detyrueshëm i kontratës”, pika 18.1, të hiqet pjesa e fjalisë si më poshtë:

“...por jo më shumë se 24 (njëzetekatër) muaj nga data e nënshkrimit të saj”
2. Ky vendim ti njoftohet sipërmarrësit Plus Communications Sh.a.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**